



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
IPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Dalës kështu

Nr. 11/448

Br.

OBILIC-OBILIC

Data 22.06.2022

Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

RAPORT

(për diskutimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025)

Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim me datë 15.06.2022 ka mbajtur diskutimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025, diskutimi është mbajtur në shtëpinë e kulturës “Xhavit Haziri” nga ora 18:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent Ibush Mjekiqi nënkryetari i komunës, Vlora Mjekiqi Kabashi – kryesuese e kuvendit, Zarife Behluli – drejtoresh e DEFZH-së dhe pjesëtarë të tjerë të ekzekutivit komunal.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 47 qytetarë, prej tyre 18 gra/vajza dhe 29 burra/djem.

- Pas prezantimit të KAB 2023-2025 kemi pranuar një kërkesë për informacion nga Qendra Rinore në Obiliq ku kanë kërkuar informata lidhur me subvencionet në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport së a është rritur buxheti për drejtorinë në fjalë në kategorinë e subvencioneve.
- ✓ Nënkyetari i komunës e ri-thekson së për vitin 2023 në kategorinë subvencione dhe transfere janë ndarë gjithsej 175,000.00€ dhe rrjedhimisht ka pasur rritje edhe në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Qytetari z. Muamer Shabani kishte kërkesë për shtruarjen e rrugë “Mentor Dervishaj” me kubëza.
- ✓ Nënkyetari i komunës tha se kjo rrugë do të jetë në listën e rrugës që do të ndërtohen në vitin e ardhshëm.

- Znj. Valentina Aliu ishte e interesuara se si do të përkraheshin projektet rinore të përbashkëta.
- ✓ Nënkyetari i komunës u zotua se të gjitha projektet që janë në interes të të rinjëve të komunës do të përkrahen nga Drejoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Znj. Xhemile Krasniqi ishte e interesuar të dinte se sa ka subvencione ne bujqësi dhe a do të përkrahen gratë që mirren me bujqësi.
- ✓ Nënkyetari i komunës tregoi se subvencione ne bujqësi për vitin 2023 janë të planifikuara 200,000.00 €. Ne ne vazhdimësi kemi subvencionuar gratë si në fushën e bujqësisë ashtu edhe në fusha të tjera dhe çdo vit kemi realizuar edhe grant skemën “Përkrahja e nënave vetëushqyese dhe gratë në biznes” dhe do të vazhdojmë t’i përkrahim me subvencione edhe viteve në vazhdim.
- Znj. Redife Krasniqi, e cila merre me bletari, u interesua të dijë a do të ketë përkrahje në këtë pjesë.
- ✓ Nënkyetari i komunës theksoi se komuna jonë çdo vit bën subvencionime të ndryshme në fushën e bujqësisë, gjithashtu çdo vit ka bërë subvencionime edhe për bletarët e komunës tonë.
- Znj. Albulena Bytyqi u interesua në fushën e studentëve dhe çështjen e transportit publik.
- ✓ Nënkyetari i komunës theksoi se në fushën e arsimit janë të planifikuara 175,000.00 € subvencione për nxënës dhe student, ndërsa për çështjen e transportit publik Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Emergjente ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me komunën e Prishtinës. Përmes këtij bashkëpunimi komuna e Prishtinës do të na ndihmoj me disa linja të transportit publik dhe gjatë këtij viti pritët të zgjidhet problemi i transportit publik.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 18:45

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq
17.06.2022



Zyrtari përgjegjës për konsultime publike - DEFZH

[Signature]
[Signature]